


# Rastet me COVID-19 po rriten në qytetin e Nju Jorkut



**Varianti delta po përhapet gjerësisht në NYC.** Ai është dy herë më infektues sesa virusi fillestar dhe mund të shkaktojë sëmundje më të rëndë.




**Variantet ndodhin kur një virus vazhdon të përhapet.** Vaksinat aktuale të COVID-19 janë efektive

kundër variantit delta, por mund të mos jenë aq efektive kundër varianteve të ardhshme. Vaksinimi tani do të ndihmojë në reduktimin e përhapjes së COVID-19 dhe zhvillimin e varianteve të reja.



**Nëse nuk jeni të vaksinuar,** duhet të mbani gjithmonë një maskë për fytyrën kur jeni rreth personave të tjerë ose kur dilni nga shtëpia, të mbani distancë fizike me të tjerët, të testoheni rregullisht dhe të qëndroni në shtëpi nëse jeni të sëmurë. Gjeneroni një qendër vaksinimi në [nyc.gov/vaccinefinder](https://nyc.gov/vaccinefinder) dhe vaksinohuni sot!



**Nëse jeni të vaksinuar plotësisht,** mbani një maskë në të gjitha hapësirat e brendshme publike dhe kudo ku nuk e dini statusin e vaksinimit të personave rreth jush. Gjithashtu, zbatoni kërkesat e secilit vend ku shkoni në lidhje me vendosjen e maskës, duke përfshirë përdorimin e transportit publik; testohuni nëse keni simptoma ose nëse jeni ekspozuar ndaj dikujt me COVID-19; dhe qëndroni në shtëpi nëse jeni të sëmurë.

Për më shumë informacion, vizitoni [nyc.gov/covidvaccine](https://nyc.gov/covidvaccine).

Departamenti i Shëndetësisë i NYC mund t'i ndryshojë rekomandimet sipas zhvillimit të situatës. 8.23.21